3. Да се дефинира национална стратегија за бездомништво, која прецизно ќе ги дефинира мерките за поддршка на оваа јавна политика;

4. Доекипирање на стручните служби во центрите за социјална работа, кои би работеле на бездомништвото како процес;

5. Развивање јасно дефиниран систем за социјална и за професионална интеграција, а преку соработка и кохеренција на различните засегнати страни (институции, граѓански сектор, бизнис-заедница, бездомници);

6. Да се ревидира политиката за пазарот на трудот за да се овозможат приспособливи работни ангажмани за категориите од трите концептуални рамки на бездомништво;

7. Обезбедување домување: користење јавно-приватно партнерство за обезбедување домување; отворање преноќевалишта и дневни центри; унапредување на условите во институционалното колективно живеење; деконцентрација на услугите за домување и во други градови во земјата; овозможување користење на државниот имот за домување на оваа целна група;

8. Развој на сервиси за здравствено и за психолошко советување: програми за соочување со зависности; програма за промена на животните стилови; системски решенија за секундарна и за терцијарна здравствена заштита

⁹ Службен везник на РМ, бр. 07 - 3478/1 од 15.9.2014

Të pastrehët rreth ne: publik,
të fshehur, potencial

Kur në publik diskutohet në lidhje me problemin e të pastrehëve, kuptimi i tij i ngushtë dhe aludimi vetëm në personat që jetojnë në rrugë, na çon drejt përfundimit se numri i të pastrehëve në Maqedoni është i pa konsiderueshëm.

Përvojat Evropiane, nuk janë të fokusuar vetën ndaj të pastrehëve publik. Duke u ndërlidhur me ETHOS¹, asociacioni për hulumtim, komunikime dhe zhvillim "Publik", përpos të pastrehëve publik (persona që nuk kanë kulm mbi kokë dhe që jetojnë në rrugë), identifikoi edhe dy kategori konceptuale persona të cilëve u kërcënohet fenomeni i të pastrehëve, si vijon: Të pastrehë potencial² dhe të pastrehë të fshehur³. Shqyrtimi i këtyllë i problemit është gjithëpërfshirës dhe mundëson krijimin politik për parandalim dhe përballje me rreziqet që rezultojnë me procesin e të pastrehëve.

Nga ana tjetër, institucionet dhe organizatat që punojnë me këtë target grup, shfrytëzojnë mënyra të ndryshme të grumbullimit të të dhënave, në mënyrë të pa standardizuar. Në mungesë të kohezionit institucional dhe për shkak të qasjes së pa koordinuar të grumbullimit të të dhënave, është vështirë të kuptohet vetë problemi, dhe në mënyrë përkatëse është i pa mundur krijimi i politikës së bazuar në prova. Sipas evidencës së Kryqit të Kuq në Maqedoni, në vend ka 318 të pastrehë. Por, në kushte të shkallës së lartë të varfërisë⁴, papunësia e lartë perzistente, ulja e kapaciteteve të sistemit për mbrojtje sociale, plakjes së popullatës, dhunës familjare, shkurorëzimeve, problemeve financiare në familje, humbja e funksionit tradicional të familjes si mbështetje sociale dhe kriza aktuale me refugjatët, pritet janë se numri është shumë i vogël. Në bazë të kësaj, përballja me këtë rrezik kërkon përcaktim strategjik të prioritetëve në nivel nacional.

Hulumtimi i realizuar nga "Publik" është hapi i parë drejt krijimit të politikave në këtë fushë, e cila bazohet në prova. Hulumtimi përdor qasje kualitative dhe është realizuar mbi gjithsej 130 njësi hulumtimi, përfshirë edhe intervista me 65 persona, përfaqësues të tre kategorive konceptuale, gjatë periudhës gusht 2015 - shkurt 2016. Rezultatet sugjerojnë nevojën për përgjigje më efikase institucionale ndaj problemit me të pastrehët dhe dhënies së prioritetëve të masave për parandalimin në agjendën e institucioneve për mbrojtje sociale. Ky dokument për politikën ka për qëllim të sqarojë fenomenin e të pastrehëve publik, të fshehur dhe potencial, shkaqet për paraqitjen, si dhe efektet sekondare mbi shëndetin mental, lidhjet sociale dhe punësimin. Më pas, dokumenti sugjeron nevojën për përgjigje institucionale për kategoritë e ndryshme konceptuale dhe përpilimin e protokollit për bashkëpunim ndër sektorial për zgjidhjen e problemit dhe i vendos bazat për zhvillimin e strategjisë me qëllim mbrojtjen e kësaj grupe vulnerable.

1.1 BAZA TEORIKE

Fenomeni i të pastrehëve mund të analizohet nga tre aspekte - si gjendje e pasjes / mos pasjes së shtëpisë, si përfshirje e kufizuar në jetën shoqërore dhe si proces në të cilin personi përballlet me problem me identitetin. Shikuar nga aspekti i parë, dukuria e të pastrehëve paraqet mungesë të vendbanimit. Person në këtë gjendje karakterizohet me deprivim në nevojave themelore njerëzore dhe për këtë shkak ndodh të ketë edhe devijime të ndryshme. Mos pasja e kulmit / shtëpisë mund të ketë karakter publik (sensu stricte) dhe karakter të fshehur (sensu largo) kur et pastrehët janë të vendosur në qendra, strehimore me mbështetje institucionale dhe jashtë institucionale, por edhe te të afërt dhe miq. Të pastrehët publik (në rrugë) shpesh paraqiten si rezultat i fenomenit të të pastrehëve potencial, që nënkupton jetesë në vendbanime jo përkatëse dhe të pa sigurta.

Të pastrehët me kalimin e kohës formojnë veçori të caktuara të sjelljes – mos përshtatje ndaj situatave shoqërore, ndërsa disa prej tyre, të sfiduar nga situata jetësore, ndodh të abuzojnë me alkoolin dhe mjete narkotike, ndërsa përfshihen edhe në veprime kriminale që të sigurojnë ekzistencën e tyre. Paraqiten çrregullime të personalitetit, sëmundje kronike dhe ngjashëm.

Fenomeni i të pastrehëve mund të ndodhë me dhunë / varfëri, nga papunësia, borxhet, hipoteka, dhunë / ose të zgjidhet si stil jete. Forma e fundit më tepër ngjan në fenomenin e endacakëve dhe është dukuri e rrallë në vendin tonë. Shembujt e evidentuar sugjerojnë se fenomeni i të pastrehëve zgjat edhe më tepër se një dekadë. Kjo na udhëzoi të mbikëqyrim të pastrehët si proces në të cilin socializimi zhvillohet në mënyrë specifike. I pastrehu "del" nga një komuniteti i caktuar sepse vazhdimisht zhvendoset nga vendi në vend. Në situatë kur personi nuk ka mundësi të realizojë disa role shoqërore, e humb lidhjen me komunitetin, ndërsa si rezultat i kësaj paraqitet edhe ndërprerja e raporteve familjare, fqinjësore dhe me miqtë. Pa mundësia të realizohen role të caktuara lidhet edhe me kontradiktat në pritshmërinë e të pastrehut. Një palë pritje kanë punëtorët socialë, si pjesë e personelit në qendrat për të pastrehë, të cilët kërkojnë prej tyre pjesëmarrje aktive në jetën e përbashkët dhe respektimin e parimeve, ndërsa pritje të tjera kanë njerëz të tjerë, të cilët dukurinë e të pastrehëve e lidhin me pasivitetin dhe apatinë. Pritjet nga i pastrehu nga personat që gjithashtu përballen me dukurinë e të pastrehëve përbën segmentin e tretë më ndryshe nga ata dy të parët dhe nga kjo prizëm dukuria duhet të shqyrtohet në suazat e interaksionit simbolik. Në pajtim me këtë, dukuria e të pastrehëve është proces, dhe jo gjendje. Për ditë i pastrehu gjithnjë e më shumë thellohet në vetminë e tij, mos pasjen e shpresës dhe në dëshpërim. Hyrja në dukurinë e të pastrehut për të paraqet një kthesë, e cila çon drejt jetës së pasigurt dhe të çrregullt. Zbrazëtira emocionale e rrit dukurinë e të pastrehut fizik (mos pasje e kulmit mbi kokë). Përfshirja në botën e të pastrehut me vete edhe nevojën për vetë përkufizim për veten si i pastrehë. Faza e parë në jetën e re në suazat e të pastrehëve publik, në pajtim me in vivo codes të grupit të caktuar të të pastrehëve, mund të ketë emra të ndryshëm. Sido qoftë, kjo është faza kur individit nuk e di se çfarë do të bëjë

¹ Tipologjia Evropiane për të pastrehë dhe për përjashtimin nga e drejta e banimit

² Persona që jetojnë në vende të pasigurta, persona që jetojnë nën kërcënimin e shpërnguljes, persona që jetojnë nën kërcënimin e dhunës dhe persona që jetojnë në vendbanime jo kenvencionale

³ Gra të strehuara në strehimore për viktima të dhunës familjare, emigrantë, persona që së shpejti duhet të lirohen nga burgu, nga institucione shëndetësore dhe institucione të tjera, ndërkaq nuk kanë vendbanim në dispozicion

⁴ 26,2 për qind në vitin 2012 dhe 24,2 për qind në vitin 2013, sipas Entit Shtetëror të Statistikës

1. Të pastrehët rreth ne: publik, të fshehur, potencial

me veten. Të afërmit nuk e njohin, ndërsa ai njëkohësisht është i panjohur edhe për të pastrehët të tjerë. Gjatë kësaj periudhë i pastrehtu nuk dëshiron të jetë i ngjashëm me të pastrehët të tjerë, të cilët për atë janë grup me të cilin nuk identifikohet. Tensioni i përditshëm në lidhje me procesin e hyrjes / depërtimit në rolin e të pastrehtit e kufizon përkatësinë e personit konkret në ndonjë grup. Gjatë kësaj faze, fillojnë konsumin e alkoolit, neglizhohet higjiena personale, personi kërkon ushqim, ndërsa kërkon edhe informata nga të pastrehët të tjerë. Ngadalë i pastrehtu nga kjo situatë e mos identifikimit hyn në botën e vet – të pastrehëve të tjerë. Procesi kur personi gjithnjë e më tepër hyn në rolin e të pastrehtit, njëkohësisht paraqet edhe fillimin e identifikimit me grupin e ri shoqëror. Duke i marrë parasysh të tri aspektet, të pastrehtun mund ta mbikëqyrin si person që ka disfunksione, i cili i humb lidhjet sociale dhe rolet dhe i cili vazhdimisht është i stigmatizuar nga personat që kanë shtëpi.

1.2 ETHOS – TIPOLOGJIA EVROPIANE PËR TË PASTREHË DHE PËR PËRJASHTIMIN NGA E DREJTA E BANIMIT

Dukuria e të pastrehëve paraqet një nga problemet kryesore shoqërore mbi të cilat fokusohet Strategjia për mbrojtje sociale dhe për përfshirjen e Bashkimit Evropian. Parandalimi nga dukuria e të pastrehëve dhe zgjidhja e çështjes banesore për personat e të pastrehë nënkupton edhe kuptimin e rrugës dhe të procesit që rezultojnë me dukurinë e të pastrehëve, me çka krijojnë perceptim të gjerë për domethënien për të pastrehët. FEANTSA (Lidhja Evropiane e Organizatave që Punojnë me të Pastrehë) zhvilli tipologji për të pastrehët dhe për përjashtimin nga e drejta e banimit, e quajtur ETHOS. ETHOS, fillon me kornizë konceptuale në të cilën përkufizohen tre segmente të cilat e përbëjnë banimin, gjatë çka mungesa e njëres prej tyre

shërben për shënimin e dukurisë së të pastrehëve. Pasja e shtëpisë nënkupton: Posedimi i hapësirës përkatëse që është vetëm në emër të personit dhe të familjes së tij/saj (DOMENI FIZIK), hapësira duhet të ofrojë mundësi për mbajtjen e privatësisë dhe relacioneve (DOMENI SOCIAL) dhe duhet të posedojë të drejtën ligjore për shfrytëzimin e hapësirës (DOMENI JURIDIK).

Kjo çon drejt katër formave themelore ose koncepteve: 1. Pa kulm mbi kokë, 2. Pa banesë, shtëpi, 3. Banim i pa sigurt, 4. Vendbanime jo përkatëse, ndërsa secila nga këto katër forma mund të përshkruhet si mungesë të shtëpisë. ETHOS i klasifikon personat pa shtëpi në raport me situatën e tyre jetësore pse situatën me shtëpinë. Këto kategori konceptuale ndahen në 13 kategori operative, të cilat mund të shfrytëzohen për përkufizimin e qëllimeve të ndryshme të politikës si shënimin e problemeve me të pastrehët, zhvillim, monitorim dhe evaluim të politikës.

1.3 ETHOS NË KONTEKSTIN MAQEDONAS

ETHOS është e përshtatur ndaj rregullativës maqedonase, rregullave institucionale dhe jashtë institucionale dhe i përjashton nën kategoritë si vijon: Persona të përkujdesur në vende për strehim urgjent, qendra për bujtje (2.1), persona të vendosur në hostele për të pastrehë (3.1), persona të vendosur në qendra për transit për të pastrehë (3.3), persona të vendosur në strehimore për punëtorë – emigrantë (5.2), persona që marrin ndihmë afatgjatë për shkak të problemit me dukurinë e të pastrehëve - përkujdesje banesore dhe strehim i ndihmuar (7.1 dhe 7.2) sepse në Ligjin për mbrojtje sociale nuk janë parashikuar mundësi për vendosjen e kësaj kategorie të personave dhe nuk janë të arritshme shërbime të këtylla. Nën kategoria 1.1 persona që jetojnë në shtëpi mobile, gjithashtu, nuk merret parasysh ndërsa në pajtim me këtë as nuk është analizuar sepse në vend nuk janë identifikuar shtëpi

Kategoria operative	Situatë nga jeta	Përkufizim i përgjithshëm	Pa kulm mbi kokë
Persona që jetojnë në kushte të vështira	*1.1 Në vend publik ose në të hapur	Jeta në rrugë ose në vende publike, pa strehë që mund të përkufizohet si vendbanim	
Persona të strehuar në strehimore urgjente	2.1 Vendstrehime për gjumë	Njerëz që nuk kanë vend të zakonshëm për banim dhe i shfrytëzojnë qendrat strehimore për të fjetur	
Persona të strehuar në strehimore për të pastrehë	3.1 Hostele për të pastrehë	Periudha e qëndrimit është afatshkurtër	
	*3.2 Strehim i përkohshëm		
Persona të përkujdesur në strehimore për gra	3.3 Vende transit për strehim	Gra, zakonisht viktime të dhunës familjare, të vendosura në qendrat strehimore, ku parashihet qëndrim afatshkurtër	
	*4.1 Strehimore për gra		
Persona të përkujdesur në strehimore për emigrantë	*5.1 *Strehim i përkohshëm / qendra strehimore	Emigrantë në strehimore dhe në qendrat e strehimit për strehim afatshkurtër për shkak të statusit të tyre si emigrantë	
	5.2 Strehimi i punëtorëve emigrantë		
Persona të cilët së shpejti duhet të lirohen nga burgji, nga institucione shëndetësore etj.	*6.1 *Institucione ndëshkimore - edukuese	Institucione ndëshkimore - edukuese	Pa shtëpi
	*6.2 *Institucione shëndetësore (përfshirë edhe qendra për rehabilitim për vartës, spitale psikiatrike)	Institucione shëndetësore (përfshirë edhe qendra për rehabilitim për vartës, spitale psikiatrike)	
	*6.3 *Institucione për fëmijë / shtëpi	Institucione për fëmijë / shtëpi	
Persona që jetojnë ndihmë afatgjate për shkak se janë të pastrehë	7.1 Strehimi i personave më të moshuar	Strehimi në afat më të gjatë me përkujdesje për ish të pastrehë (zakonisht për periudhë më të gjatë se një vit)	Vendbanime të pa sigurt
	7.2 Strehimi i asistuar për ish të pastrehë	Jeton në vendbanim konvencional jo të përhershëm, vendbanimin e shfrytëzon sepse nuk ka shtëpinë e tij	
Persona që jetojnë në vendbanime të pa sigurt	*8.1 Strehim të përkohshëm të të afërmit dhe miq të afërt	Uzëpim i tokës (pa dokumente juridike për qira)	Vendbanime jo përkatëse
	*8.2 Pa marrëveshje legale për dhënie (marrje) me qira	Uzëpim i tokës (pa dokumente për posedimin e tokës)	
	*8.3 Tokë e uzurpuar		
Persona që jetojnë në vendbanime nën kërcënimin të dëbohen	*9.1 Vendim gjyqësor i miratuar për dëbim (vendbanim me qira)	Vendimi për dëbim ka hyrë në fuqi	
	*9.2 Konfiskim i shtëpisë të dhënë në hipotekë	Kreditori posedon vendim ligjor për konfiskimin e pronës	
Persona që jetojnë nën kërcënimin e dhunës	*10.1 Incidente të regjistruara nga policia	Policia vepron me qëllim sigurimin e strehimit të sigurt për viktimën e dhunës familjare	
	11.1 Shtëpi mobile	Banim në shtëpi të përkohshme në të cilën nuk ka kushte për jetë	
Persona që jetojnë në vendbanime të përkohshme jo konvencionale	*11.2 Objekte jo konvencionale	Vend strehim ose barakë e suspenduar	
	*11.3 Struktura të përkohshme	Tendë ose kasolle	
Persona që jetojnë në kushte të pavolitshme për banim	12.1 Uzëpim i objektit që nuk është i përshtatshëm për banim	E përkufizuar si vendbanim jo përkatës sipas legjislacionit nacional ose rregullativës për banim	
Persona që jetojnë në shtëpi me shumë banorë	13.1 Sipas normës më të lartë për banim të shumë banorëve në nivel nacional	Në rastin kur tejkalohej norma nacionale për numrin e personave që jetojnë në një dhomë	

- NË MAQEDONI JANË PËRCAKTUAR KATEGORITË E SHËNUARA ME YLL (*)

të këtylla. Nuk janë marrë parasysh edhe kategoritë operative të personave që jetojnë në kushte banesore të pa përshtatshme (12.1) dhe persona që jetojnë në shtëpi të mbipopulluara (13.1) sepse, në pajtim me përkufizimet e përgjithshme të dhëna në ETHOS, vendbanimi jo përkatës dhe norma për mbipopullim në shtëpi, duhet të përkufizohen në kornizën ligjore. Legjislacioni maqedonas nuk njih përkufizime të këtylla. Në vend, në strategjinë nacionale për banim (2007 - 2012), identifikohen nocionet banim përkatës dhe minimal, por të njëjtat nuk janë përkufizuar qartë. Në strategjinë, nocioni banim përkatës nënkupton banimin e normuar, të cilin shoqëria e konsideron si të kënaqshme, respektivisht si

standard për banim që është përkufizuar si qëllim shoqëror, që duhet të realizohet në të ardhmen. Çfarë nënkuptohet me banim të normuar, të cilën shoqëria e konsideron si të kënaqshme, nuk është përkufizuar. Nocioni banim minimal është më restriktiv në përcaktimin e nivelit të standardit të cilin shoqëria e përkufizon si nivelin më të ulët të standardit në banim dhe i përfshin standardet fizike dhe juridike të cilat duhet ti sigurojë ky nivel që të përcaktohen si nevoja më të vogla themelore të shfrytëzuesve. Edhe në këtë përcaktim, nuk ekziston përcaktim i qartë se çfarë nënkuptojnë standardet fizike dhe juridike.

REZULTATE NGA HULUMTIMI I REALIZUAR TË PASTREHË PUBLIK				
	Shkaqe për paraqitjen e të pastrehëve	Shëndeti fizik dhe mental	Lidhje sociale	Punësimi
1.1 Persona që jetojnë në kushte të vështira	Konflikte familjare: Shkurorëzime, çështje pronësore – juridike të pa zgjidhura, dhuna familjare	- Kanë sigurim shëndetësor dhe legjitimacion shëndetësor - Në mënyrë të rregullt vizitojnë mjekun amë - Probleme shëndetësore kronike (kancer, trombozë, hiperglikemi dhe hipertension, astma, epilepsi) - Vartës të alkoolit dhe drogës - Vuajnë nga pagjumësia, të vjellat, kokë dhimbje, nervozë të vazhdueshme	- Nuk komunikojnë me familjen, të afërmit dhe miqtë, as me mjedisin - Kanë qëndrim diskriminues ndaj mjedisit - Rrallë realizojnë kontakt me institucione shtetërore dhe shoqata të qytetarëve	- Nuk janë proaktiv gjatë kërkimit të punës, duke pritur ndihmë dhe lëshime nga rrethina - Realizimi i angazhimit të punës afatgjatë është sfida më e madhe për këtë grup
TË PASTREHË TË FSHEHUR				
	Shkaqe për paraqitjen e të pastrehëve	Shëndeti fizik dhe mental	Lidhje sociale	Punësimi
4.1 Persona të përkujdesur në qendra strehimi për të pastrehë	-Konflikte familjare: Shkurorëzime, dhunë familjare, raporte familjare të çrregulluara - Mashtrim financiar - Hipoteka	- Pjesa më e madhe kanë sigurim shëndetësor dhe legjitimacion shëndetësor - Probleme shëndetësore kronike - Vuajnë nga pagjumësia, të vjellat, kokë dhimbje, nervozë të vazhdueshme	-Banimi kolektiv kontribuon drejt solidarizimit me të madh dhe shoqërimin ndërmjet banorëve dhe ata realizojnë raporte të afërta të mira miqësore - Rrallë janë në kontakt me familjet e tyre më të gjera -Rrallë realizojnë kontakt me institucione shtetërore dhe shoqata të qytetarëve	- Nuk janë proaktiv gjatë kërkimit të punës - Ju nevojiten më tepër informata për qasje drejt punës, si të aplikojnë për banesa sociale, si mund të fitojnë kualifikime plotësuese dhe profesionalizim pune, si dhe nëse do të ndikojë statusi aktual mbi pensionimin e tyre të ardhshëm
4.1 Persona të përkujdesur në qendrat e strehimit për gra	Dhuna nga bashkëshorti/ partneri	- Pjesa më e madhe kanë sigurim shëndetësor dhe legjitimacion shëndetësor - Pa probleme shëndetësore të konsiderueshme	- Marrëdhënie familjare të rrënuara dhe raporte me familjen më të gjerë dhe me fëmijët -Rrallë realizojnë kontakt me institucione shtetërore	- Vendi i punës i viktimave të dhunës familjare shpesh është nën kërcënim për shkak të situatës së tyre të përjetimit të dhunës në afat më të gjatë, për shkak të ndryshimit të lokacionit gjatë vendosjes në qendrat e strehimit ose për shkak të rrezikut nga hakmarrja e dhunës - Ju nevojitet asistencë gjatë punësimit që të kenë mundësi të jetojnë të pavarura
5.1 Strehimi i përkohshëm/ qendra për strehim	/	- Sigurimi shëndetësor dhe kanë legjitimacione shëndetësore - Vizitojnë mjekun rregullisht - Vuajnë nga sëmundje kronike të zemrës, luktit, ndërsa vuajnë edhe nga hipertensioni, diabeti, depresioni, por edhe nga ftohja e zakonshme, si rezultat i kushteve për jetë	- Realizojnë kontakt me familjen e tyre më të gjerë Prindër, fëmijë, farefis - Nuk janë të pranuar mirë nga rrethi më i gjerë - Nuk kanë kontakt me institucionet ose organizata civile	- Disa nga fëmijët e refugjatëve janë kyçur në programin për punësim të subvencionuar, por nuk janë punësuar pas përfundimit të programit - Disa nga gratë thonë se nuk punojnë sepse nuk ka kush të kujdeset për fëmijët e tyre - Ju nevojitet leje për punë, por edhe ndihmë gjatë procedurës administrative për pajisje me lejen për punë
6. Persona të cilët së shpejti duhet të lirohen nga burgju, nga institucione shëndetësore etj.	- Familjare: Shkurorëzim, vdekje e njërit nga partnerët martesor, raporte familjare të çrregulluara - Stres psikik - Borxhe financiare - Hipoteka	- Pjesa më e madhe kanë sigurim shëndetësor dhe kanë legjitimacione shëndetësore - Kohë pas kohe ankohen për shqetësime shëndetësore por nuk kanë sëmundje kronike - Personat pa shtëpi pas përkujdesjes institucionale janë përplot me pa siguri, stres, përpjekje për vetëvrasje, por edhe pikëllim për shkak se janë braktisur nga familja dhe nga shoqëria	- Etiketim i familjeve me persona me probleme psikike bën që familja e tyre e afërt ti vizitojë rrallë - Komuniteti më i gjerë nuk ka mirëkuptim për situatën e tillë, i etiketonin, kritikonin dhe dënonin.	- Qasje e kufizuar drejt tregut të punës

TË PASTREHË PITENCIAL				
	Shkaqe për paraqitjen e të pastrehëve	Shëndeti fizik dhe mental	Lidhje sociale	Punësimi
6.1*Institucione ndëshkuese, 6.2 Institucione Shëndetësore (përfshirë edhe qendra për reabilitim për vartës, spitale psikiatrike) 6.3 Institucione për fëmijë/ shtëpi	Shkurorëzim, dhunë familjare, të shkurorëzuar ose prindër që ju kanë vdekur dhe raporte familjare të çrregulluara, janë shkaqet kryesore për të cilat personat largohen nga shtëpitë e tyre dhe kanë kërkuar ndihmë nga miqtë dhe nga të afërmit. Shkurorëzim dhe braktisje e shtëpisë në të cilën kanë jetuar me partnerin e tyre është shkak për të cilin personat kanë vendosur të banojnë padrejtësisht	- Qasje e kufizuar drejt shërbimeve shëndetësore - Kohë pas kohe ankohen për shqetësime shëndetësore por nuk kanë sëmundje kronike - Storjet jetësore individuale të personave që nuk kanë shtëpi pas kujdesit institucional janë shumë të pa sigurt, me stres, dhunë, përpjekje për vetëvrasje	- Këta persona kanë nevojë për socializim, në veçanti jashtë institucionit. Një pjesë ndihen të harruar nga institucionet dhe nga qendrat për punë sociale - Etiketim i familjeve me persona me probleme psikike bën që familja e tyre e afërt ti vizitojë rrallë - Komuniteti më i gjerë nuk ka mirëkuptim për situatën e tillë, i etiketonin, kritikonin dhe dënonin.	- Qasje e kufizuar për mundësinë për punësim - Personi i liruar nga institucioni ndëshkues korrigjues është pa punë dhe pa të ardhura të vazhdueshme mujore. Personat që janë larguar nga institucioni për fëmijë pa kujdes të prindërve punojnë në diskoteka, pa rrogë, vetëm me bakshishe - Duhet të mendohet për masa alternative për punësim
8.1 Strehim i përkohshëm te prindër dhe miq të afërm, 8.2 Pa marrëveshje legale për qira, 8.3 Tokë e uzurpuar	Shkurorëzim, dhunë familjare, të shkurorëzuar ose prindër që ju kanë vdekur dhe raporte familjare të çrregulluara, janë shkaqet kryesore për të cilat personat largohen nga shtëpitë e tyre dhe kanë kërkuar ndihmë nga miqtë dhe nga të afërmit.	- Qasje e kufizuar drejt shërbimeve shëndetësore - Të varur nga alkooli	- Mos besim ndaj institucioneve, por edhe marginalizim dhe diskriminim në bazë etnike - Ndihen të vetmuar dhe të izoluar. Kanë rreth të vogël të miqve, vetëm disa prej miqve kanë shtëpitë e tyre - Rrallë janë në kontakt me familjen e tyre me të gjerë Prindër, fëmijë, farefis - Nuk kanë kontakt me institucione të tjera shtetërore dhe shoqata të qytetarëve	- Shpesh janë shfrytëzues të ndihmës sociale - Sigurimi i shtëpisë dhe punësimi janë nevoja e drejtpërdrejtë për personat që përkohësisht janë të vendosur te të afërmit e tyre dhe miqtë ose janë strehuar në mënyrë jo ligjore
9.1 Është miratuar vendim ligjor për shpërngulje (vendbanim i marrë me qira), 9.2 Konfiskimi i shtëpisë të dhënë nën hipotekë	Shkurorëzim, dhunë familjare, të shkurorëzuar ose prindër që ju kanë vdekur dhe raporte familjare të çrregulluara, janë shkaqet kryesore për të cilat personat largohen nga shtëpitë e tyre dhe kanë kërkuar ndihmë nga miqtë dhe nga të afërmit.	- Pjesa më e madhe kanë sigurimi shëndetësor dhe kanë legjitimacione shëndetësore - Pjesa më e madhe e personave të marrë në pyetje fizikisht ndihen të shëndetshëm dhe nuk kanë pasur ekzaminime mjekësore gjatë vitit të fundit. Disa përballen me sëmundje kronike të shkaktuara nga ushqimi i keq dhe i pa rregullt, konsumi i alkoolit ose astma, hipertensioni - Mos pasja e sigurisë i bën të acaruar dhe nervoz në jetën e tyre të përditshme	- Rrallë janë në kontakt me familjet e tyre me të gjerë Prindër, fëmijë, farefis - Kanë realizuar kontakt me institucione të tjera shtetërore dhe shoqata të qytetarëve - Asnjë nga personat nuk ka qenë i përkujdesur në ndonjë institucion për mbrojtje sociale	- Ju duhen më tepër informata për punësim, institucione që mund tu ndihmojnë në realizimin e të drejtave të tyre sociale, por edhe të drejtat për qiramarrës të vendbanimeve, informatë për mënyrat si mund të fitojnë banesë sociale ose strehim në institucione për persona të moshuar
10.1 Persona që jetojnë nën kërcënimin e dhunës	Një person për shkak të shitjes së banesës ishte detyruar me dhunë të braktisë vendbanimin e marrë me qira dhe ka marrë afat përfundimtar prej tre jave, dhe për momentin jeton te miku i tij prej nga duhet të largohet për shtatë ditë - Dy të tjerët për shkak të mos pagimit të qirave dhe faturave për shërbime komunale duhet të largohen nga vendbanimi. Për dy personat e fundit problem të veçantë paraqesin faturat e larta për rrymë gjatë muajve të dimrit	Të gjithë të anketuarit janë të siguruar shëndetësor dhe kanë legjitimacione shëndetësore. Gjatë vitit të fundit, dy nuk kanë përdorur asnjë ekzaminim shëndetësor dhe nuk janë përballur me probleme shëndetësore të caktuara. Përveç që janë të shqetësuar dhe nervoz për shkak të situatës në të cilën gjenden. Një prej tyre lufton me bronhitis kronik - Stresi dhe frika janë pjesë e përditshmërisë së tyre	- Stigmatizimi dhe dhuna nga familja dhe mjedis më i gjerë paraqesin traumë plotësuere në jetën e tyre. Raportet familjare të pa zgjidhura, në veçanti me fëmijët, u shkaktojnë dhimbje, por janë të vetëdijshëm se largimi i dhunës ka qenë zgjidhja e vetme për ata - Përvoja e tyre me institucionet nuk është në nivel të kënaqshëm. Gratë ankohen në lidhje me raportin e policisë, e cila shpesh është e butë, madje edhe korruptohet në situata kur përfshihet dhuna familjare. - Dhuna familjare tërësisht i ka rrënuar raportet familjare dhe raportet me familjen më të gjerë dhe me fëmijët	- Vetëm një grua është e punësuar dhe një tjetër është shfrytëzuese e pensionit invalidor
11.2 Objekte jo konvencionale, 11.3 Struktura të përkohshme	Raporte familjare të pa zgjidhura janë qenë shkak më i shpeshtë që disa herë është dashur të ndërrojnë vendbanimin, të jetojnë me qira, në vende që i ndan me kushërinj të tjerë ose thjesht në "rrugë". - Nga ana tjetër, për ata që jetojnë në ndërtime të përkohshme, shkaqe për humbjen e shtëpisë kanë qenë shkurorëzimi, varfëria familjare, vdekja e prindit që ka qenë bartës i financave në familje ose rrezimi i shtëpisë së ndërtuar në mënyrë jo ligjore	- Të gjithë personat janë të siguruar shëndetësor dhe kanë legjitimacione shëndetësore - Pjesa më e madhe e personave të marrë në pyetje fizikisht ndihen të shëndetshëm dhe nuk kanë pasur ekzaminime mjekësore gjatë vitit të fundit. Disa përballen me sëmundje kronike ose me probleme orale të shkaktuara nga ushqimi i keq dhe i pa rregullt, kanë vështirësi neurologjike të shkaktuara nga stresi dhe nga frika	Personat që jetojnë në kushte substandarde me familjet e tyre thonë se rrallë largohen nga lagjia dhe nga rrethina e afërme që të vizitojnë qytetin. Zakonisht shoqërohen me fqinjët dhe me të afërmit. Personat që jetojnë në ndërtime të përkohshme, gjithashtu, janë të izoluar nga aspekti social dhe jetojnë jetë të vetmuar. Thonë se rrallë shoqërohen me të pastrehë të tjerë, edhe pse njohin shume të pastrehë ose persona në rrezik social	- Ju duhen më tepër informata për punësim, qasje për mikrokreditim ose donacione për sanimin e shtëpive, qasje për kyçje infrastrukturore për ujë, rrymë dhe për kanalizim Të gjithë, përveç një personi, janë pranues të ndihmës sociale, kompensimit për më shumë fëmijë ose kompensimit për nënë të vetë mbajtur (për këtë shkak një person do të vazhdojë të jetojë në bashkësi jashtëmarte-sore). Financat e tyre variojnë ndërmjet 1.200 dhe 5.000 denarë në muaj. Financa plotësuere të pa konsiderueshme fitojnë nëpërmjet grumbullimit të shisheve plastike, ofrojnë ndihmë të kohë pas kohe në tregje, pastrojnë ose shesin revistën "Lice v lice"

REKOMANDIME PËR POLITIKË

Dukuria e të pastrehëve dhe përjashtimi nga e drejta e banimit janë format më ekstreme të varfërisë dhe të përjashtimit social. Në nivel evropian deri sot, qasja te të dhënat zyrtare për të pastrehët është shumë e kufizuar. Në Maqedoni, për çështjen me të pastrehët nevojitet zhvillim gradual i politikës. Nuk ekziston përkufizim juridik i pranuar për të pastrehët, ndërsa institucionet publike dhe publiku më i gjerë kanë mirëkuptim shumë të ngushtë për fenomenin.

Duke e pasur parasysh kontekstin aktual në Maqedoni, konstatimet nga analiza krahasuese e realizuar, intervistat me personat që jetojnë si të pastrehë publik, të fshehur ose potencial, të prezantuara dhe të elaboruara në opsionet / skenarët politik si vijon, pas çka rekomandohet alternativa më e mirë.

- Opsioni për politikë / Skenari 1: Status kuo,
- Opsioni për politikë / Skenari 2: Përkufizimi gjithëpërfshirës dhe i gjerë i të pastrehëve, sipas përkufizimit të propozuar të zhvilluar nga "Pablik", në pajtim me ETHOS dhe inkuorporimi i saj në dokumentet nacionale ekzistuese.
- Opsioni për politikë / Skenari 3: Përkufizimi i ngushtë i të pastrehëve dhe kuptimi i tij vetëm në segmentin e të pastrehëve publik.

OPSIONI PËR POLITIKË / SKENARI 1: STATUS KUO

Hulumtimi i prezantuar në këtë raport ka treguar se në Maqedoni ekziston dukuria e të pastrehëve, mirëpo, mungon sistemi për matjen dhe monitorimin e trendëve, si dhe dizajni i politikës publike si përgjigje ndaj kësaj dukurie.

Në kushte të shkallës së lartë të varfërisë⁵, papunësia perzistente e lartë, ulja e kapaciteteve të sistemit të mbrojtjes sociale, plakja e popullatës, dhuna familjare, shkurorëzimi, probleme financiare në familje, humbja e funksionit tradicional të familjes si mbështetje sociale dhe kriza aktuale me refugjatët, pritet janë se numri është shumë më i lartë.

Në bazë të kësaj, përballja me këtë rrezik kërkon përcaktim strategjik të prioriteteve në nivel nacional.

Në kushte të këtyra, status kuo në zhvillimin e politikës publike, e cila e prek dukurinë e të pastrehëve si proces, do të rezultojë me: Mungesë të përkufizimit në nivel nacional për kuptimin gjithëpërfshirës të të pastrehëve si proces, 2) mungesa e të dhënave zyrtare për monitorimin e trendëve me të pastrehët në vend dhe përgjigje e koordinuar institucionale në mbrojtjen e të drejtës për banim, 3) qëndrimi në pengesat e ekzistuese ligjore, të cilat kategorive të ndryshme të të pastrehëve u pamundësojnë realizimin e të drejtës për punësim, mbrojtje sociale dhe shëndetësore, 4) mos identifikim i mëtejshëm nga gjykata maqedonase të dispozitave të Konventës Ndërkombëtare për të Drejta Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në pjesën që vlen për ndërprerjen e shpërnguljes së detyruar nga shtëpia derisa nuk ofrohet vend tjetër për banim përkatës, 5) vazhdimi i mungesës së kohezionit sistemor në politikë, rolet e institucioneve dhe përfshirjes aktive të faktorëve të tjerë shoqërorë, si sektori civil dhe afarist në krijimin e zgjidhjeve përkatëse të politikës dhe strategjive për luftë kundër të pastrehëve.

⁵ 26,2 për qind në vitin 2012 dhe 24,2 për qind në vitin 2013, sipas Entit Shtetëror të Statistikës

OPSIONI 2: OPSIONI PËR POLITIKË / SKENARI 2: PËRKUFIZIMI GJITHËPËRFSHIRËS DHE I GJERË I TË PASTREHËVE, SIPAS PËRKUFIZIMIT TË PROPOZUAR TË ZHVILLUAR NGA "PABLIK", NË PAJTIM ME ETHOS DHE INKORPORIMI I SAJ NË DOKUMENTET NACIONALE EKZISTUESE.

Rezultatet nga hulumtimi i realizuar sugjerojnë se në Maqedoni, edhe përpos përfaqësimit të vogël të të pastrehëve publik (16,9 për qind), ekziston rrezik i madh për rritjen e këtij numri për shkak të përfaqësimit më të lartë të personave që jetojnë si të pastrehë të fshehur (38,5 për qind) dhe të pastrehë potencial (44,6 për qind). Së këndejmi rezultoni nevoja për dizajnimin e masave parandaluese.

Në rrezik më të madh që të bëhen të pastrehë janë:

1. Në bazë të arsimimit: Personat me arsim fillor (29,2 për qind) dhe personat pa arsim (20 për qind)
 2. Në bazë të statusit familjar: Të ndarë / Të shkurorëzuar (30,8 për qind) dhe beqarë (26,2 për qind),
 3. Në bazë të grupit të moshës: Persona të moshës prej 40 deri në 50 vjeç (27,7 për qind) dhe persona të moshës prej 50 deri në 60 vjeç (27,7 për qind),
 4. Në bazë të gjinisë: Bura (90,9 për qind) dhe gra (9,1 për qind).
- Në pajtim me rezultatet e hulumtimit të realizuar, ekipi i "Pablik" e formuloi përkufizimin e parë për të pastrehë.

TË PASTREHË është proces i cili i përfshin personat me kyçje të kufizuar në jetën shoqërore, të cilët kanë probleme me identitetin e tyre dhe janë pa vendbanim, jetojnë në kushte të pa sigurta dhe / ose jo përkatëse ose, po, përkujdes janë të strehuar në strehimore ose në institucione.

Nëse përkufizimi i propozuar pranohet dhe inkuorporohet në Ligjin për mbrojtje sociale, do të duhet të priten efektet pozitive si vijon: Njohje ligjore të të pastrehëve dhe vendosje e një sërë masave juridike për veprim, 2) do të jenë të qasshme të dhëna përkatëse sipas kategorisë, që nga ana tjetër do të mundësojë dizajnimin e politikave të bazuara mbi prova, 3) do të sigurohet grumbullimi i të dhënave, të cilat janë krahasuese me të dhënat e vendeve të BE-së, që do të sigurojë përfaqësim të përforcuar dhe lobim për mbrojtjen e të drejtës për banim.

Diskutim mbi kategori konceptuale

- **TË PA STREHËT PUBLIK** përfshin njerëz të cilët janë të pastrehë dhe pa përkrahje në gjetjen e strehimit.

Nëse përkufizimi i propozuar pranohet dhe inkuorporohet në Ligjin për mbrojtje sociale dhe në qoftë se janë propozuar

sociale, si të aplikojnë për banesa sociale ose të vendosen në institucione për të moshuarit. Por, gjithashtu, këta persona kanë nevojë dhe për këshilla të ekspertëve për të drejtat e tyre si qira-kërkues dhe ndihmë juridike falas në raste të avokimit të të drejtave të tyre para gjykatës. Përfshirja e pushtetit lokal është e rëndësishme të madhe në sigurimin e zbulimit të shpejtë dhe ndihmë emergjente të këtyre njerëzve, veçanërisht në muajt e parë të dëbimit nga vendbanimi.

III. Personat që jetojnë nën kërcënimin e dhunës: 1) Përmirësimin e vetëdijes së popullatës së përgjithshme për shërbimet dhe mënyrat e mbështetjes institucionale (përfshirë edhe ndihmën ligjore) në situata të dhunës familjare; 2) Përmirësimi i mbrojtjes sociale në rastet e dhunës familjare; 3) Zhvillimi i zgjidhjeve institucionale për parandalimin dhe reagimin e duhur dhe të shpejtë në krizë, sidomos në ditët e para të largimit nga shtëpia, të rregulluara me akt nënligjor; 4) Programe për ndihmë psiko-sociale dhe ndihmë individuale për personat të cilët kanë qenë viktimë të dhunës familjare; 5) Sigurimi i mbrojtjes në vendin e punës së viktimave dhe rregullimi i saj me Ligjin për parandalimin dhe mbrojtjen kundër dhunës familjare⁹; 6) Sigurimi i strehimit i mbështetur ligjërisht i rregulluar me Ligjin për parandalim dhe mbrojtje kundër dhunës familjare.

IV. Persona që jetojnë në vendbanime të përkohshme të pazakonta: 1) Dhënia e ndihmës për punësim; 2) Hartimi i opsioneve për mikrokredi si në shembullin e “ Habitat Maqedonia”, të cilët me kursimoren bankare “Mozhnosti” iniciuan linjë krediti që ofron kredi të vogla për rindërtimin dhe renovimin e shtëpive substandarde. Këta individë kanë nevojë për shërbime jo-financiare në formën e këshillave dhe trajnimeve se si në mënyrë më efektive, të qëndrueshme t'i rinovojnë shtëpitë e tyre; 3) Përcaktimi i standardeve për strehim adekuat dhe minimal sipas shembullit të vendeve të BE-së dhe rregullimin e tyre me Ligjin për banim.

OPSIONI PËR POLITIKË/ SKENARI 3: PËRKUFIZIMI I NGUSHTË I TË PASTREHËVE DHE KUPTIMIN E SAJ VETËM NË PËRFSHIRJE TË TË PASTREHËVE PUBLIK

Siç u tha tashmë në hartimin e opsionit të dytë për politikë, në Maqedoni është e nevojshme të merren masa urgjente në drejtim të veprimit parandalues në kategoritë konceptuale të pa strehët potencial të fshehur. Në të kundërtën, mund të pritet rritje të numrit të njerëzve që janë të pastrehë publik. Përkufizimi i ngushtë i të pastrehëve dhe të kuptuarit e tyre vetëm në përfshirjen e të pastrehëve publik do të çojë në zhvillimin e politikave publike, fokusi i të cilit është ri integrimi i personave të cilët janë të zhytur thellë në procesin e të pastrehëve.

OPSIONI I REKOMANDUAR

Mbështetja strategjike nga shteti për mbrojtjen e të drejtës për strehim është kritike për zhvillimin e mëtejshëm të kësaj politike publike. Përndryshe, Maqedonia do të vazhdojë të ngecë në realizimin e kësaj të drejte njerëzore dhe do të vazhdojnë të krijohen kushte për zhvillimin e mëtejshëm të përjashtimit social, në vend të reduktimit të saj. Dështimi i një shteti për të

matur në mënyrë efektive dhe dokumentimin e të pastrehëve, përfshirë edhe format më pak të dukshme, çojnë në mungesë të zhvillimit të një zgjidhje adekuate në nivel kombëtar. Mungesa e të pastrehëve në strategjitë kombëtare për luftimin e varfërisë dhe përjashtimit social e konfirmon marginalizimin e të pastrehëve.

Mungesa e përcaktimit ligjor dhe një sërë të masave ligjore të përfshira në Ligjin për mbrojtje sociale (lex specialis) rezultojnë me disa nevoja: 1) përcaktimin e të pastrehëve në nivel shtetëror (gjegjësisht, politika, strategji me mbështetje të planeve vepruese dhe buxhetit); 2) Programet dhe masat aktive për të parandaluar dhe për të dalë nga gjendja e të pastrehëve; 3) Mbështetje lokale e bazuar në nevojat e komunitetit e siguruar në nivel komunal; 4) Promovimin e inovacioneve sociale dhe ndërtimin e kapaciteteve dhe arsimimin e sipërmarrësve social; 5) Regjistrat adekuat të të dhënave nga kategori të ndryshme të njerëzve të pastrehë. Për këto arsye, skenari me status kuo (opsioni 1 për politikë) nuk ofron ekosistem të favorshëm për zhvillimin gradual të pastrehëve si politikë publike dhe përkufizimin e prioriteteve strategjike në nivel nacional ose lokal.

Në disa vende, të tilla si Finlanda, Danimarka dhe Holanda ekzistojnë strategji nacionale për tu ballafaquar me të pa strehët. Vende të tjera si Gjermania, Austria dhe Skocia kanë zhvilluar qasje të decentralizuara. Sistemi “së pari shtëpi” është sugjerimi më popullor për zgjidhjen e problemeve të njerëzve të pastrehë në shumicën e vendeve: Danimarkë, Finlandë, Holandë, Itali, Austri, Skoci dhe Gjermani, ndërsa në Kroaci është në rrjedhë zbatimi i projektit të parë të tillë. Edhe pse “së pari shtëpi” nuk është qasje e pranuar gjerësisht në Slloveni dhe shumë pak vëmendje i kushtohet vendbanimeve ekzistuese, megjithatë në Lubjanë është zhvilluar një program që është i fokusuar në strehime kalimtare. Në dhjetor 2010, Parlamenti Evropian mbështeti aktivitete në lidhje me të pastrehët me Deklaratën 61/2010. Për disa kohë në të gjithë botën ka diskutime për ri përkufizimin e politikës sociale ndaj të pa strehëve. Nga rregullimi i ligjor dhe ballafaqimi me të pastrehët (managing homelessness) drejtë zgjidhjes së problemit (ending homelessness).

REKOMANDIME

Me qëllim që të përshpejtohet zhvillimi i politikave publike në Maqedoni, e cila është drejtuar në të drejtën për strehim, nevojiten masa proaktive për mbështetje. Këto rekomandime janë të përcaktuara në bazë të hulumtimeve dhe analizave dhe kanë për qëllim të kontribuojnë në zhvillimin e një politike të volitshme dhe projektim të masave adekuate për mbështetje. Rekomandimet operative për palët e ndryshme të interesuara janë, gjithashtu, të përkufizuara, në mënyrë që e pranojnë rolin e pjesëmarrësve të ndryshëm në zhvillimin e të drejtës për strehim.

REKOMANDIME OPERACIONALE

Rekomandimet për institucionet publike:

1. Të zhvillohet politikë për të pastrehët në përputhje me rekomandimet e kësaj analize përmes procesit me pjesëmarrje të dialogut dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara;

2. Të rritet ndërgjegjësimi i institucioneve të ndryshme përkatëse (Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, qendrat për punë sociale, të pushtetit vendor, Enti për Çështje Sociale) për rëndësinë e të drejtës për strehim dhe për efektet dytësore të këtij procesi në shëndetin mendor, marrëdhëniet shoqërore dhe punësimin;

3. Të përkufizohet strategjia nacionale për të pastrehët që do t'i përcaktojë me saktësi masat për ta mbështetur këtë politikë publike;

4 Ekipim i shërbimeve profesionale në qendrat për punë sociale që do të punojnë në të pastrehët si proces;

5. Zhvillimi i një sistemi të përcaktuar qartë për integrim social dhe profesional, përmes bashkëpunimit dhe koherencës së palëve të ndryshme të prekura (institucioneve, shoqërisë

civile, komunitetit të biznesit, të pastrehët);

6. Të rishikohet politika e tregut të punës për të lejuar vendosjen e angazhime pune të përshtatshme për kategoritë nga tre kornizat konceptuale të të pa strehëve;

7. Sigurimin e strehimit: përdorimi publik - partneritet privat për të siguruar strehim; Hapje të bujtinave dhe qendrave ditore; përmirësimin e kushteve në banimin institucional kolektiv; dekoncentrimi i shërbimeve të strehimit në qytete të tjera të vendit; mundësimi i përdorimit të pronës shtetërore për strehim të këtij target grupi;

8. Zhvillimi i shërbimeve për këshillim shëndetësor dhe psikologjik: programe për ballafaqimin me varësitë; program për të ndryshuar mënyrën e jetesës; zgjidhjet e sistemit për kujdesin shëndetësor dytësor dhe tretësor.

⁹ Gazeta Zyrtare e RM-së nr. 07 - 3478/1 të datës 15.9.2014.

Homelessness Around Us: Public, Hidden, Potential

1. Homelessness Around Us: Public, Hidden, Potential

When publicly discussing the problem of homelessness, its narrow understanding and its connection exclusively with the people living on the street leads to a conclusion that the number of homeless people in Macedonia is insignificant.

The European experiences are not focused only on the public homelessness. In line with ETHOS¹, the Association for research, communications and development “Public”, in addition to the public homelessness (homeless people without roof over their heads and living on the street), identified two additional conceptual categories of persons who are threatened with homelessness, as follows: potential homelessness² and hidden homelessness³. Such consideration of the problem is comprehensive and enables policy making for prevention and for dealing with the risks that lead to homelessness.

On the other hand, the institutions and the organizations working with this target group use different manners for collection of data in a non-standardized manner. In the absence of institutional coherence and in view of the uncoordinated approach to data collection, it is difficult to understand the problem itself and thus it is impossible to create an evidence-based policy. According to the records of the Red Cross of Macedonia, in the country there are 318 homeless people. However, given the high rate of poverty⁴, the persistently high unemployment rate, the decrease of the capacities of the social security system, the aging of the population, the domestic violence, the divorces, the financial problems in the family, the loss of the traditional function of the family as a social support and the ongoing refugee crisis, the expectations are that the figure is much higher. Therefore, dealing with this risk requires strategic priority setting at national level.

The research conducted by “Public” is the first step towards the creation of an evidence-based policy in this area. The research uses a qualitative approach and it was conducted on a total of 130 research units, including interviews with 65 people, representatives of the three conceptual categories, in the period August 2015 - February 2016. The results point to the need for more effective institutional responses to the problem of homelessness and giving priority to the measures for prevention in the agenda of the social protection institutions. The purpose of this policy document is to explain the phenomenon of public, hidden and potential homelessness, the causes for the occurrence, as well as the secondary effects on the mental health, the social relationships and the employment. Furthermore, the document indicates the need for an institutional response to the different conceptual categories and for development of a protocol for cross-departmental cooperation for dealing with the problem. It also lays the foundations for the development of a strategy aimed at the protection of this vulnerable group.

1.1 THEORETICAL BASIS

